



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafi 1, pika 1.3 e Statutit të Komunës së Gjiçanit, (01.Nr.016-126211 të dt.06.11.2014), në zbatim të nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, me Rekomandim të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 01.Nr.48/2015, të datës 28.05.2015 si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me date 29.06.2015, miraton :

V E N D I M

Paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për periudhë afatshkurtër (prej 15 vite), personave fizik dhe juridik.

1. Kuvendi i Komunës së Gjiçanit **Aprovon Propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën afatshkurtër prej 15 vite, me pagesë, personave fizik dhe juridik, ngastrën kadastrale :**
 - P-70403013-01345-0, lloji i njësisë : parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, sipërfaqja: 9384 m², e cila gjendet te vendi i quajtur "Zabeli i Sahit Agës", lloji i shfrytëzimit të parcelës : tokë bujqësore, e pronarit: P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjiçan, Zona Kadastrale - Gjiçan.
2. Prona e përshkruar në pikën (1) të Vendimit është tokë bujqësore dhe e njejta ipet në shfrytëzim për zhvillimin e veprimtarive bujqësore (Agro-Biznesit), dhe nuk lejohet shfrytëzimi i saj për qëllime tjera.
3. Shfrytëzuesi potencial i kësaj prone obligohet që pronën e marr në shfrytëzim ta ruaj si nikoqir i mir duke e ia shtuar vlerën e saj, ti ruaj karakteristikat dhe vlerat unike të saj dhe të kujdeset për ruajtjen e mjedisit.
4. Obligohet Komisioni Vlerësues i Ofertave që pasë plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, t'i zbatojë procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatshkurtër në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafi 6 i Ligjit Nr.04/L-144, dhe me dispozitat e Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të cilat realizohen përmes konkurrencës së hapur publike, me konkurs publik në formë të ankandit.

5. Të ardhurat të cilat do të inkasohen nga dhënia në shfrytëzim të kësaj prone, janë para publike dhe i nënshtrohen respektimit të dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatshkurtër ta regjistrojë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
8. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-60798
Gjilan, më 29.06.2015

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku -Rexhepi/